



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201502556/2

Tiranë ____/____/2016

Lënda : *Rekomandohet marrja e nismës për ndryshim në legjislacion*

Drejtuar : **Ylli Manjani**
Ministër i Drejtësisë

TIRANE

I nderuar Z. Ministër,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në procesin e shqyrtimit të ankesave të depozituara nga shtetas të ndryshëm, ka konstatuar se, Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor, ka kryer veprime përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, duke vendosur masën e sekuestrës dhe mbi të ardhurat mujore të përfituara nga pala debitore si ndihmë ekonomike.

Kryerja e kësaj veprimtarie prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv, nuk është se vjen në kundërshtim me parashikimet e ndonjë dispozite konkrete ligjore, dhe aq më tepër me parashikimet e nenit 529/6 "*Sendet mbi të cilat nuk mund të vihet sekuestroja*" të Kodit të Procedurës Civile, i cili përjashton nga sekuestrimi i pasurisë së debitorit ; "*ndihmat që u jepen nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa se studimit përveç kur detyrimi është për ushqim. Në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës*".

Institucioni i Avokatit të Popullit në procesin e shqyrtimit të ankesës së një shtetaseje, ka konstatuar, se, Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor, ka vendosur masën e sekuestrës mbi të ardhurat e përfutur si ndihmë ekonomike prej bashkëshortëve debitor, të cilat jepen në favor të tyre, konform ligjit nr.9355, datë 10.03.2005, "*Për ndihmën dhe shërbimin shoqërore*", të ndryshuar, Qëllimi për të cilin jepet ndihma ekonomike dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, është që nga ana e tyre të mund të sigurohet plotësimi i nevojave bazë jetike, zhvillimi i aftësive dhe i mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.

Gjithashtu, qëllim i këtij ligji është të zbus varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre. Përkundër këtij qëllimi të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005, të ndryshuar, si dhe parimeve mbi të cilat funksionon skema e ndihmës dhe e shërbimeve shoqërore, si;

- a) respekti dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit;
- b) universaliteti;
- c) barazia e mundësive;
- ç) e drejta për të përfituar;
- d) partneriteti;
- dh) transparenca dhe paanshmëria;
- e) decentralizimi;
- ë) pavarësia, integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit;
- f) mosdiskriminimi;
- g) karakteri subvencionues;

nuk mund dhe nuk duhet të kryhen veprime përmbartimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv mbi të ardhurat e përfituara si ndihmë ekonomike. Procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë, kuptohet se, nuk vjen në përputhje me parimet e lartpërmendura në rastin e vendosjes së masës të sekuestrës mbi të ardhurat e debitorit të siguruara si ndihmë ekonomike. Institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrim të detyrës së tij, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, mbështetur në parashikimet e nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe parashikimet e nenit 24 të ligjit nr. 8454, date 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, se: *“Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkaku që krijon premisë për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë : a) t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin e përmirësimin e ligjeve....;*

REKOMANDOJMË

“Marrjen e nismës për ndryshimin e dispozitës ligjore, neni 529/6 të Kodit të Procedurës Civile, duke përfshirë në të dhe ndihmën ekonomike si send mbi të cilin nuk mund të vendoset masa e sekuestrës.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 22 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes të mundësohet bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Konceptoi dhe Daktiligrafoi: A.Gjoleka